



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:028379

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05934472

**C.nr.29/2022**

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil**, gjyqtari Petrit Curri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses E.Mnga fshati G./Malishevë të cilën e përfaqëson i ati F.M, e i cili e ka autorizuar për përfaqësim shoqërinë e avokatëve “A.I” rruga “Bill Klinton” në Prishtinë, kundër të paditurës kompania e sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike ”Kompensim dëmi”, vlera e kontestit 2,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 12.07.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **KONSTATOHET** se paditësja E.Mtë cilën e përfaqëson i ati F.M, e i cili e ka autorizuar për përfaqësim shoqërinë e avokatëve “A.I”, **e ka tërhequr padinë** që identifikohet në këtë gjykatë me shenjën C.nr.29/2022 e datës 28.01.2022, kundër të paditurës kompania e sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike ”kompensim dëmi”.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja E.Mtë cilën e përfaqëson i ati F.M, e i cili e ka autorizuar për përfaqësim shoqërinë e avokatëve “A.I” rruga “Bill Klinton” në Prishtinë, me datë 28.01.2022 në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës kompania e sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, me bazë juridike ”Kompensim dëmi”, vlera e kontestit 2,500.00 euro.

Përfaqësuesi i paditëses, me datë 11.07.2024 e ka dorëzuar në këtë gjykatë parashtrësën për tërheqjen e padisë në këtë çështje juridiko-kontestimore, duke e njoftuar gjykatën se e tërheqin padinë dhe arsyeja e tërheqjes së padisë C.nr.29/2022 e datës 28.01.2022, është se me të paditurën kanë arritur pajtim jashtëgjyqësor.

Gjykata vlerëson se konform nenit 3.1 të LPK-së, i cili i referohet parimit të disponibilitetit, palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat e parashtruara në procedurë kontestimore, përfshirë edhe tërheqjen e padisë, veprim ky i përcaktuar me dispozitën nga neni 261 par.1 të LPK-së, e cila parasheh që: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”*.

Bazuar në faktin se paditësi e ka tërhequr padinë para se të paditurës ti dërgohet padia me shkresat e lëndës për përgjigje në padi, e në rastin konkret nuk kërkohet pëlqimi i të njëjtës, atëherë gjykata vlerëson se janë përmbushur prezumimet procedurale për të vepruar konform dispozitës nga neni 261 par.3 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Prandaj duke u gjendur në një gjendje të këtillë, gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil**  
**C.nr.29/2022, datë 12.07.2024**

**Gj y q t a r i**  
**Petrit Curri**

**Udhëzim juridik:** *Kundër këtij Aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa konform nenit 261 par. 4 të LPK-së.*